

PREPORTR



SABOTUESIT

KEK—KORPORATA E KORRUPSIONIT

Një hulumtim i Preportr për qarkullim të mbi 1 miliard eurove nxjerr se Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) është foleja ku keqpërdorimet kanë në përgjithësi vlera milionëshe.

Visar Duriqi dhe Qëndrim Bunjaku (2-4)

MASOUD KEKYAN – ZOTI I ENERGJISË

Këshilltarët e huaj në KEK pyeten që nga blerjet e mëdha, tek dokumentet strategjike e deri në largim të punëtorëve nga puna. Besa Kalaja e Besnik Boletini (5-7)

KEK-U, VENDI KU RRASËN TË GJITHË

Në asnjë vend nuk bashkohen krimi i bizneseve, politikanëve, e individëve vendor e ndërkombëtar si në Korporatën Energjetike e Kosovës – KEK. Avni Zogiani (7-8)

KEK

KORPORATA E KORRUPSIONIT

VISAR DURIQI DHE QËNDRIM BUNJAKU

Një hulumtim i Preportr për qarkullim të mbi 1 miliard eurove, mbi 500 milionë euro investime publike që nga viti 2000 dhe i mbi 550 milionë eurove të dhuruara përmes 500 tenderëve publikë që nga viti 2007, nxjerr se Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) është foleja ku keqpërdorimet kanë në përgjithësi vlera milionëshe, ku ndikimi politik është i pashmangshëm, e ku më të dëmtuarit dalin konsumatorët kosovarë e më të shpërblyerat kompanitë serbe. Hulumtimi nxjerr se edhe hetuesit e Komisionit Evropian gjetën përfitime milionëshe nga ndërkombëtarët e vendorët, por që drejtësia i ka heshtur këto raste. KEK-u pashmangshëm del si Korporata e Korrupsionit pasi që shpërblyeri i kompanive që dështuan investime milionëshe si dhe i atyre që nuk i përmbushën kontratat është fenomen mbizotërues.

Biznese të huaja e vendore për dhjetë vjet me radhë kanë marrë qindra miliona nga KEK-u, shpesh duke i shitur kësaj korporate paisje të amortizuara për të reja, por edhe shërbime e energji me çmim shumëfish më të lartë se ai i tregut

Në kuadër të këtij hulumtimi, ku janë shqyrtuar mbi 500 tenderë publik të lëshuar nga KEK-u, në vlerë prej rreth 550 milionë eurosh ku përfituese e kësaj shume janë 200 kompani vendore e ndërkombëtare, del se janë shpërblyer kompani me tenderë milionësh edhe pse pajisjet që i kanë shitur KEK-ut kanë dalë jashtë përdorimit brenda një kohe shumë të shkurtër. Në mesin e këtyre kompanive përfshihen edhe dy prej kompanive që janë përfituesit më të mëdhenj në KEK, kompania “Eco trade” e familjes Zhugolli, nga Podujeva, dhe kompania “Intering” e familjes Shoshi nga Banja e Pejës.

Po ashtu, “Preportr” ka krahasuar listën e penaltive të akorduar nga KEK-u në vitin 2010 dhe listën e 200 përfituesve më të mëdhenj. Nga këto 200 kompani, 25 prej tyre janë penalizuar nga KEK, përderisa 18 prej tyre, me gjithë penalizimin nga KEK-u, kanë vazhduar të përfitojnë tenderë në vlera deri në 1 milion euro. Në mesin e këtyre kompanive të penalizuara është edhe kompania: “I & A sh.p.k” e familjes Zhugolli.

Informacionet e dala nga ky hulumtim i “Preportr”, tregojnë po ashtu se edhe kur KEK ka prodhuar mjaftueshëm energji për kërkesat e konsumit vendor, është detyruar të ndalë gjeneratorët e vetë për të përmbushur kontratat e importit të energjisë elektrike, që nga kompanitë serbe blehej me çmime shumëfish më të larta sesa ato të tregut.

Disa herë më të larta kanë qenë çmimet e energjisë së impor-

tuar për KEK nga kompanitë, një pjesë e konsiderueshme e tyre kompani serbe, që jo rrallë janë quajtur “mafia ballkanike e energjisë”, por edhe përkundër paralajmërimeve të ndërkombëtarëve e vendorëve se do të ndërmerren masa kundër “obstruksioneve” të Serbisë, deri sot asnjë veprim i tillë nuk dihet të jetë ndërmarrë.

Ndër përfituesit më të mëdhenj në KEK janë kompanitë serbe krahas dy kompanive vendore, ajo e familjes Zhugolli, nga Podujeva dhe ajo e familjes Shoshi nga Banja e Pejës. Në vitin e parë të udhëheqjes të kësaj qeverie, në vitin 2008, Njazi Thaçi nënshkroi kontratat më të mëdha që janë dhënë deri më tash për import të energjisë, prej mbi 51 milionë eurosh, që kryesisht u jepet kompanive serbe. Në një kontratë tjetër, kompania shtetërore serbe “14. October”, ka përfituar rreth 50 milionë euro për furnizimin e KEK-ut

me paisje të transportimit të dheut e qymyrit, të cilat kanë dalë nga funksioni për disa javë. Në këtë tender, pjesë e konzorciumit ka qenë edhe “Eco trade”, pronë e familjes Zhugolli nga Podujeva, e cila edhe përkundër djegies së kësaj kontrate, ka vazhduar të marrë tenderë, duke arritur madje shuma marramendëse të tenderëve, rreth 170 milionë euro vetëm nga KEK-u, shumë kjo e fituar vetëm nga viti 2007.

SHTËPIA ME DY KONAKË


Ishte viti 2007 dhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK) e Kryeministri Hashim Thaçi po përgatitej të vinte në pushtet. Në “kampionin e tenderëve”, Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK), që realizon mbi 30 % të vlerës së krejt prokurimeve që kryhen në Kosovë, zyrës së prokurimit i printe kushëriri i kryeministrit, Nijazi Thaçi.

Investimet publike, para nga

buxheti i Kosovës të alokuara në formë të subvencioneve, të bëra në këtë korporatë që nga paslufta kalojnë vlerën mbi 500 milionë euro. Kurse vetëm me anë të tenderëve të mëdhenj prej vitit 2007, që ka hulumtuar “Preportr”, janë shpërblyer 200 kompani mu tenderë që së bashku peshojnë afro 550 milionë euro. Ndikimi politik në KEK është i pashmangshëm në pjesën më të madhe të investimeve duke qenë se kompanitë që kanë dështuar investimet milionëshe të kësaj korporate nuk janë penguar të vazhdojnë biznesin me këtë kompani publike. Në prokurimet publike ka pasur shpërblyerje të kompanive e familjeve të caktuara në tenderët që së bashku kapin shumën mbi 240 milionë euro. Raporte të ndryshme auditimi tregojnë se KEK është e mbushur me skandale. Ato janë të faktuara edhe nga hetuesit e Komisionit Evropian, por të heshtura nga drejtësia.

KOMPANITË E PENALIZUARA

SIPAS LISTËS SË PENALTIVE QË POSEDON "PREPORTR", KOMPANITË QË JANË NDËSHKUAR NGA KEK-U NË FUND TË VITI 2010 PËR SHKELJE TË KONTRATËS ME KËTË KORPORATË JANË:



Kurse, për mospërbushje të kontratës së lidhur me KEK-un, por këto vetëm për nga një sosh, janë:

"ENGINEERING" • NTPSH "XANI" • "ELEKTRO D T PROJEK" • "PBC KOSOVA" • "SOLID COMPANY" • "RIPTEN ENGINEERING" • "EURO IMPEX" • "E-PROJEKT" • "NNP. TONI", NTPSH "XANI" • "ADRIA-7" • "PEG" • "FAMORDI" • "PROF. ENGINEERING PEG" • "EUROO TRADE" • "ATM" • "ALKOM" • "I&A" SH.P.K • "KOSOVA CONSTRUCTION" • "B&L" • "MONT ENGINEERING" • "ATM-PR" • "SIMENS" • "MONTCOMERCE" • "FAMORDI" • "GRAMOZI" • "FEKI" • "G3 INXHINJERING" • "NTP SOLAR" • "ABC INXHINJERING" • "RIPTEN ENGINEERING" • "NILOS" • "RIMA" • "SJERRA"

Këto kompani së bashku, me tenderët e përfshirë në listën e penaltive, kanë marrë tenderë në vlerë mbi 1.8 milionë euro, derisa vlera e përbashkët e tyre që kanë paguar në xhirollogari të KEK-ut, si dënim, është vetëm 184.227 euro.

Në këtë mes të kompanive, janë edhe 18 kompani të cilat kanë marrë tenderë edhe pas penalizimit. Vlera e këtyre tenderëve arrin mbi 6.7 milionë euro.

së avullit dhe gjeneratorit elektrik në Blllokun A3, me afro 3 milionë euro. Në të njëjtin tender, në Llotin e dytë partneri i TurboCare, Interling, merr afro 9 milionë euro për riparimin kapital të kaldajës.

Kurse familja e Kryeministrit Thaçi është e lidhur me tenderin për shitjen e thëngjillit. "OVE Group", pronë e Visar Banijcës nga Maqedonia ishte kompania, ankesa e të cilës e anuloi tenderin për shitjen e thëngjillit të shpallur sivjet, që ende ka mbetur në procedurë, i anuluar së fundi për mungesë ofertuesish të përgjegjshëm. Në këtë kompani, kur mbante emrin "BOXON", aksionar ishte edhe Milaim Cakiqi, biznesmen nga Drenasi që figuron të jetë aksionar në disa biznese me vëllain e vogël të Kryeministrit Thaçi, Blerimin. Cakiqi, sipas raportimit të gazetës JNK, aktualisht kanë një kompleks të përbashkët ndërtesash të ndërtuar nga "Iliria Buliding".

Visar Banjica është person kontaktues edhe në kompaninë tjetër nga Tetova, "Polog", kompani e cila ka fituar në KEK, 2 tenderë në vitin 2009 në vlerë 140,240 euro.

Një tjetër familje e rëndësishme në PDK është përfituese në KEK. Familja e deputetit Shqip Muja nëpërmjet kompanisë "Doni" dhe "Ci-Kos", pronë e Fatmir Mujës, është e kontraktuar për shitjen e

skrapit të KEK-ut, ku Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka gjetur një sërë parregullsish.

Për hetuesit e Komisionit Evropian (OLAF) Fadil Ismajli, tash kryeshef i KOSTT-it është në konflikt të interesit për tenderët publik milionësh të fituar të kompanisë "Komtel", ku ai ishte bashkëthemelues me Vegim Gashin. I fundit ishte kandidat i Aleancës Kosova e Re për kryetar të Prishtinës, parti kjo e ish-presidentit të multi-milionerit kosovar, Behgjet Pacolli.

Hetuesit e OLAF-it nuk kanë lënë "rehat" as ish-biznesmenë, tash deputetë të opozitës kosovare. Sipas raportit të hetuesve në fjalë, dhënia me koncesion e Hidrocentralit Kozhner (Lumbardhi) kishte shkuar me keqpërdorime. Atë e mori me koncesion kompania "Triangle", që edhe në deklarimin e pasurisë për vitin 2012, deputeti i Vetëvendosjes, Florin Krasniqi shkruan se i mban ende 25 % të aksioneve. Vetë Krasniqi publikisht kishte deklaruar se në Kosovë asnjë punë nuk kryhet pa dhënë rryshfet.

Korporata edhe para ardhjes së PDK-së në pushtet kishte qenë vendi mirë për t'u keqpërdorur fondet prej dhjetëra milionësh, edhe pse korporata deri në vitin 2010 ishte audituar nga Auditori Gjeneral vetëm një herë, dhe atë në vitin 2005.

"KURDISJA" E TENDERËVE NJËBURIMOR

Sipas raporteve të punës së Agjencionit të Prokurimit Publik (APP), i ndryshuar tash në Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP), KEK-u pos në prokurimet në përgjithësi, është korporata që është kampion edhe në tenderët njëburimor. Kjo metodë e dhënies së tenderëve njëburimor, është kritikuar në vazhdimësi nga Raporti i Progresit si metodë që çon te tenderë me rrezikshmëri për favorizim.

Në kohën kur në KEK, Zyra e prokurimit udhëhiqej nga Njazi Thaçi, në APP drejtor ishte emëruar Ilir Rama, që qëndroi në këtë detyrë deri në korrik të vitit 2010.

Me të lëshuar punën në APP, pasi qëndroi mbi një vit e gjysmë si ushtrues detyre, në kundërshtim të plotë me ligjin që lejonte atë kohë mbajtjen e pozitës me ushtrues detyre vetëm deri në gjashtë muaj, Ilir Rama u punësua në KEK si zyrtar për prokurim.

Bazuar në të dhënat e KRPP-së nga viti 2007 deri më 2011, Rama i kishte lejuar KEK-ut 26 tenderë njëburimor, për dallim që në kohën kur ky nuk ishte drejtor në APP, KEK-ut i ishin lejuar vetëm 6 tenderë të tillë. Rama ka qëndruar në krye të APP-së për një vit e gjysmë (2008-korrik 2010). Tash, kur legjislacioni i ri në fuqi i lejon institucionit që të procedojë tender

PDK-ja që kur erdhi në pushtet është e ndërlidhur ngushtë me tenderët milionësh të KEK-ut, në njërin anë nëpërmjet kushëririt të kryeministrit, Njazi Thaçi që deri vonë udhëhoqi zyrën e prokurimit të KEK-ut, dhe nëpërmjet ish-drejtorit të Agjencionit të Prokurimit Publik (APP), Ilir Rama që tash punon në KEK, dhe nga ana tjetër nëpërmjet kompanive të familjes Zhugolli nga Podujeva. Kjo familje mban medaljen e artë në përfitimin e tenderëve publik në KEK.

Familja Zhugolli ka përfituar nga KEK-u, vetëm nga viti 2007, rreth 170 milionë euro nga tenderët e mëdhenj, shumë kjo e marrë së bashku me gjithë konzorciume, kompani të regjistruara në Kosovë e me përfaqësitë e saj ndërkombëtare. Përderisa familja Shoshi, nga Banja e Pejës që me krejt kompanitë e saj, me tenderë të fituar me kompani të veçanta e me konzorciume, ka marrë hise në tenderë të KEK-ut në vlerë afro 70 milionë euro.

Familja Zhugolli ka edhe një lidhje tjetër me partinë në pushtet. Bejtush Zhugolli, që ka në pronësi kompaninë "Pejton" dhe "I & A sh.p.k", për fushatën elektorale të partisë së Kryeministrit Thaçi në vitin 2009 dha zyrtarisht 900 euro.

Bejtush Zhugolli, financuesi i PDK-së, del të jetë edhe më i fuqishëm se vëllezërit e tij kur bëhet fjalë për tenderët e KEK-ut, që deri vonë udhëhiqeshin nga kushëriri i Kryeministrit Hashim Thaçi, Njazi.

As mos përbushja e kontratave të fituara me kompaninë "I & A sh.p.k" nuk e ndalon Bejtush Zhugollin që të marrë nga KEK tenderë. Ai nga kjo korporatë, vetëm në vitin 2010-2011 ka përfituar tenderë në vlerë prej 4.1 milionë eurosh së bashku me konzorciume, por, megjithëse në vitin 2010 u penalizua për mos përbushje të dy kontratave, në vitin 2011 është shpërblyer edhe me tri kontrata të tjera, vlera e të cilave është mbi 1.5 milionë euro.

Dy familjet prijëtare në tenderë në KEK, Zhugolli e Shoshi bashkohen te tenderi i vitit 2008 prej mbi 70 milionë eurosh për ndërrimin e shiritave transportues të thëngjillit nga Sibovci, investim për të cilin ish-ministri i Ekonomisë, Ahmet Shala pati thënë se ky projekt është një nga projektet më të mëdha në dy dekadat e fundit, por që dështoi një natë para natës së vitit të ri 2010. Në këtë tender, në një pjesë si konzorcium me "Eco Trade" të familjes Zhugolli është hisedar edhe kompania "IMK 14 Oktobar" nga Serbia, kurse pjesa tjetër, prej mbi 22 milionë eurosh është fituar nga "Interling" e familjes Shoshi me "Magdeburger Forderantagen Und Baurnaschinen GmbH". KEK-u ka vazhduar të shpërblejë këto kompani, të familjes Shoshi e Zhugolli pa problem edhe pas dështimit të investimit në fjalë.

Është interesante se edhe "Eco trade", por edhe "Interling", si për-

fitueset më të mëdha nga KEK-u, kanë një pikë të përbashkët. Ka raste kur për shembull "Interling" e familjes Shoshi futet në konzorcium me kompani të huaja përfaqësuese e të cilave është "Eco trade". "ThyssenKrupp Fördertechnik", sipas faqes zyrtare, përfaqësohet nga "Eco trade" e Zhugollëve, por ka fituar tenderë me "Interling" të Shoshëve, në rastin e Rehabilitimit të Blllokut A4 në vlerë prej 8.7 milionë eurosh në vitin 2006. Rehabilitimi i një blloku të Kosova A në vitin 2006 ka dështuar vetëm rreth dhjetë ditë pasi që ish-ministri i energjisë Et'hem Çeku dhe ish-ministri i drejtësisë Januz Salihaj e kishin inauguruar këtë investim. Asnjëherë nuk është bërë e ditur nëse investimi që dështoi për dhjetë ditë ishte ai i bërë nga "Interling", për shkak se KEK-u nuk ka ose nuk jep të dhëna për tenderët para vitit 2007. Sido që të jetë përshkrimet e dhëna nga mediat në qershor të vitit 2007 dhe atyre të gjetura nga "Preportr" tregojnë se gjatë kësaj periudhe ky ishte investimi i vetëm i kësaj shkalle në rehabilitimin e blloqueve të Termocentralit "Kosova A". As për këtë dështim nuk ka dhënë askush llogari.

Në një tender tjetër të vitit 2008, partneri i kompanisë Interling, pronë e familjes Shoshi nga Banja e Pejës, "Turbo Care" nga Polonia, i shiti KEK-ut një transformator në shumën prej 3.7 milionë eurosh. Ky transformator u dogj për më pak se 3 orë punë. Ishte blerë i përdorur edhe pse një ofertë e një kompanie bullgare ia kishte ofruar KEK-ut një transformator të ri me të njëjtat karakteristika për rreth 800 mijë euro. Ky grup interesi ka vazhduar të marrë tenderë në KEK edhe përtej këtij dështimi skandaloz dhe deri më sot nuk është ndërmarrë asnjë nismë ligjore për ta rikuperuar këtë dëm. KEK-u, në përgjigjet e dhëna për "Preportr" në pyetjen nëse ekziston një nismë ligjore kundër kompanisë vetëm konfirmon se ka iniciuar një nismë të tillë, por nuk ka ofruar asnjë dokument që vërteton paraqitjen e kësaj nisme kundër kompanisë që ia dogji 3,7 milionë euro. Çuditërisht, kjo kontratë nuk është gjetur as te njoftimet publike në faqen zyrtare të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP).

Në korporatë pretendonin se për shkak të dëmit që i ka shkaktuar korporatës "Turbo Care", nga një gjykatë e arbitrazhit, ishte ngritur rast automatikisht kundër kësaj kompanie. Fillimisht, deklarimi i zyrtares për media, Eglantina Hoxha, ka qenë se pasi ka dështuar ky transformator, KEK-u do të blejë një tjetër si ky nga kompania Konçar, kurse ndaj "Turbo Care" do të ndërmerren masa. Kjo nuk ndodhi asnjëherë, por përkundrazi "Turbo Care", bashkë me partnerin e saj, kompaninë e Shoshëve "Interling" u shpërblye edhe me tutje me tenderë nga KEK, siç është rasti i tenderit të riparimi kapital i turbinës

► VAZHDON NGA FAQJA 3

njëburimor pa leje të APP-së, KEK-u vetëm deri tash, në vitin 2012, ka realizuar 15 tenderë njëburimor.

Në një përgjigje për “Preportr”, Rama mohon çdo ndërlidhje në mes numrit më të madh të tenderëve njëburimor të lëshuar për KEK-un nga APP-ja e drejtuar nga ai, në krahasim me APP-në e drejtuar më vonë nga Mursel Raci. Rama dhe menaxhmenti i KEK-ut, shprehen se ka pasur një degradim për të, nga drejtor i APP-së në zyrtar të Prokurimit në KEK.

Për ta gjithçka ka shkuar “OK”, pasi që Ilir Rama u pranua në KEK me një konkurs publik dhe ishte më i miri i krejt konkurrentëve. Njëjtë shprehen edhe në APP për punësimin e kushërirës së Njazi Thaçit, Libonës, njëherë si asistente e drejtorit, atëherë Ilir Ramës, dhe tash e avancuar në zyrtare e prokurimit në këtë institucion.

Për ta, nuk ekziston asnjë lidhje në mes këtyre lëvizjeve, ani pse me largimin e Ilir Ramës nga APP, numri i tenderëve njëburimor për KEK-un ka rënë dukshëm.

“Lidhur me zvogëlimin e aprovimit të kërkesave në KEK, percepticioni shumicë e pakicë, janë më shumë çështje të prirjeve për thashetheme dhe paragjykime, sepse numri i aprovimeve llogaritet në raport me kërkesat e inicuar në periudhë kohore, e jo në raport numerik”, konstaton ish-drejtori i APP-së, tash i punësuar te tenderët e KEK-ut.

Me shkuarjen e Ramës në KEK, Njazi Thaçi është avancuar nga shefi i prokurimit, në pozitën e drejtorit operativ të kompanisë që në vazhdimësi ka luajtur rolin edhe të zëvendës drejtorit të korporatës.

BAJRAKTARI PËR FITIMEVE – SERBIA

Kompanitë serbe, duke llogaritur edhe blerjet e energjisë, të cilat që nga paslufta e deri më tani janë mbi 365 milionë euro, por edhe tenderët e tjerë, janë përfituesë të afro 400 milionë eurove vetëm nga KEK-u.

OLAF gjeti lidhje të dyshimta te tenderët e kompanive serbe të importit të energjisë, që kryesisht që nga viti 2000 e deri më tani paraqiten emrat “Rudnap” me seli në Beograd, “Geni”, po ashtu nga Beogradi, dhe kompanisë “EFT” që ka seli në Londër, por që rrënjët i ka në shtetin serb.

Për hetuesit evropian mes KEK-ut e kompanive serbe janë kryer transaksione të dyshimta. Për këtë është përdorur “Artesia Bank” me seli në Greqi, ku përfitues ka qenë biznesmeni Vuk Hamovic, e në këtë bankë kanë përfunduar pagesat për firmat “EPCG”, “EFT” dhe “Rudnap”, që sipas “OLAF”-it konsiderohen si rrjeti ballkanik i energjetikës. Poashtu, sipas këtij hetimi, dyshohet për lidhje ndërmjet “EFT”-së dhe “Rudnap”, të cilat udhëhiqen nga një grup i njëjtë i biznesmenëve,

si Vuk Hamović, Vojin Lazarević e James Nye. Përveç në “Artesia Bank”, Hamović dhe Lazarević janë partnerë edhe në bankën “EuroAsix”, me seli në Beograd. Aksionar në kompaninë “Rudnap” është edhe biznesmeni Damir Fazlić, i cili akuzohet për krime ekonomike në Ballkan, kurse në Shqipëri opozita e akuzon Kryeministrin Sali Berisha se e mban Fazliqin për mik të afërt.

Nga këto përfitime të kompanive serbe nuk llogaritet dëmi prej afro 10 milionë eurosh për çdo vit që ia shkakton shteti serb Kosovës nëpërmjet restriksioneve e taksave shtesë në rrjetin e transmissioinit, dëme këto që i bënë publike vetë kryeshefi i KOSTT-it, Fadil Ismaili. Ai, në prani të Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqajt akuzon Serbinë se po përkrah, siç e quan ai, mafian ballkanike të energjisë, e ministri garanton se do ta denoncojnë këtë shtet në mekanizmat përkatës, por nuk dihet se çka kanë bërë tutje, ani pse nga këto deklarime gati u bënë një vit. Gati u bënë një vit edhe nga deklarimet e Krye-këshilltarit të KEK-ut, Masoud Keyan, që po planifikon të ankohet në Vjenë kundër Serbisë për deformimin e çmimit të energjisë që importojnë kosovarët pasi kjo mund të jetë në kundërshtim me rregullat e Komunitetit të energjetikës. Ai nuk ka dashur t’i përgjigjet ‘Preportr’ se a e ka realizuar planin për ankesë dhe as nëse KEK është ankuar ndonjëherë në Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë.

Pyetjeve të ‘Preportr’ për rrjetet e transmissioinit u kanë ikur personat përgjegjës në KOSST. Ata thonë se që nga viti 2007 më nuk publikojnë se prej nga hynë energjia elektrike e importuar, përderisa në raportet publike përmendet më së shumti transmissioni me Serbinë, ani pse Kosovës i kushton shumëfish më shtrenjtë kjo energji për shkak të tarifave shtesë që ky shtet aplikon kundër Kosovës, gjë të cilën e pranojnë edhe zyrtarët e KEK-ut. Kosova nga kompanitë e importit blenë energji me çmim prej 75 eurosh për megavat, përderisa një MË nga KEK-u prodhohet me një kosto prej 27-30 euro.

Transmissioni me Malin e Zi përmendet të ketë shkuar në remont shumë shpesh dhe nuk përjashtohet mundësia që brenda vitit të jetë riparuar edhe më shumë se një herë.

SABOTIMI I TERMOCENTRALEVE KOSOVARE PËR LLOGARI TË IMPORTIT NGA KOMPANITË SERBE

Për këshilltarët ndërkombëtarë të KEK-ut pse kjo korporatë në vitin 2008 bleu më së shumti energji elektrike, mbi 51 milionë euro, ishte



faktor vetë kushëriri i Kryeministrit Thaçi, Nijaziu.

Në një raport intern të vitit 2008 të kompanisë PA, e kontraktuar nga USAID-i si këshilltar i KEK-ut konstatohet se pas disa muajsh të lojërave të luajtura nga shefi i prokurimit të KEK-ut, siç thuhet në raport “ një kushëri i Kryeministrit”, dhe pasi që Ministria e Ekonomisë dhe Financave siguroi se kishte fonde, u hap një tender për blerjen e energjisë për periudhën tetor 2008 – mars 2009. “Çmimet ishin 20% më të shtrenjta sesa në tenderët e mëhershëm”, konstaton raporti.

Raporti i PA bënë një akuzë serioze ndaj menaxhmentit të KEK-ut. Ky raport thotë se në nëntor të po këtij viti KEK-u kishte tepriçë të prodhimitarisë edhe pas furnizimit me 24 orë energji për shkak të motit të ngrohtë. “Megjithatë KEK-u është dashur të ndalë gjeneratorët e vet për shkak të kontratave të bëra për blerjen e energjisë me kompani importuese”, thuhet në raportin në fjalë.

TENDERËT E FAMILJEVE ZHUGOLLI E SHOSHI

Dy familje kosovare, Zhugolli e Shoshi prijnë në tenderët milionësh të përfituar nga KEK-u. Kjo ka dal nga një hulumtim i Qendrës Kosovare për Gazetari Hulumtuese dhe Organizatës ÇOHU! në të cilin është bërë klasifikimi dhe gjetja e përfituesve të tenderëve publik në KEK që nga vitit 2007, dhe atë vetëm të tenderëve me vlera të mëdha.

Familja Zhugolli vetëm nga viti 2007 ka përfituar 170 milionë euro nga tenderët e KEK-ut.

- Bejtush Zhugolli, financues i PDK-së, për mospërbushje të dy kontratave me kompaninë “I & A sh.p.k” u penalizua nga KEK-u më 2010, megjithëkëtë në vitin 2011 përfitoi tri kontrata të tjera, vlera e të cilave është mbi 1.5 milionë euro. Ky financues i PDK-së, në KEK, dhe si i vetëm, por edhe me konzorciume, ka marrë tenderë në vlerë prej 4.1 milionë eurosh.

Kompanitë me të cilat familja Zhugolli morri tender në KEK: “ACDC-Kos”, “Eco Trade”, “I & A sh.p.k”, **Përfaqësitë e Zhugollëve që kanë përfituar nga KEK-u:** “ThyssenKrupp Fördertechnik”, “Siemens”.

Familja Shoshi ka përfituar rreth 70 milionë euro nga KEK-u.

- Në një tender tjetër të vitit 2008, partneri i kompanisë “Intering”, pronë e familjes Shoshi nga Banja e Pejës, “Turbo Care” nga Polonia, i shiti KEK-ut një transformator në shumën prej 3.7 milionë eurosh. Ky transformator u dogj për më pak se 3 orë punë.

Kompanitë me të cilat familja Shoshi morri tender në KEK: “Intering” (Xhevdet Shoshi, Arben Shoshi), “N. Interling GmbH” (Gani Shoshi)

Ku bashkohen familjet Zhugolli e Shoshi?

Dy familjet prijëtare në tenderë në KEK, Zhugolli e Shoshi bashkohen te tenderi i viti 2008 prej afro 50 milionë eurosh për ndërrimin e shiritave transportues të thëngjil-lit nga Sibovci, investim për të cilin ish- Ministri i Ekonomisë, Ahmet Shala pati thënë se ky projekt është një nga projektet më të mëdha në dy dekadat e fundit, por që dështoi një natë para natës së viti të ri 2010. Në këtë tenderë është hisedar edhe “ThyssenKrupp Fördertechnik”, sipas faqes zyrtare, përfaqësohet nga “Eco trade” e Zhugollëve, ka fituar më 2006 tender për Rehabilitimit të Bllokut A4 në vlerë prej 8.7 milionë eurosh. Këtë tender e kishte fituar me “Intering” të Shoshëve. Rehabilitimi i një blloku të Kosovës A në vitin 2006 ka dështuar vetëm rreth dhjetë ditë pasi që ish-ministri i energjisë Et’hem Çeku dhe ish-ministri i drejtësisë Jonuz Salihaj e kishin inauguruar këtë investim. Asnjëherë nuk është bërë e ditur nëse investimi që dështoi për dhjetë ditë ishte ai i bërë nga “Intering”.

Sipas këtij raporti këto kontrata, që kryesisht u lidhën me kompani serbe e u nënshkruan nga dora e kushëririt të Kryeministrit Thaçi, e kanë obliguar KEK-un, të paguaj edhe nëse praktikisht nuk e shfrytëzon këtë energji.

HORDHITË E HUAJA

Hetuesit e Komisionit Evropian patën gjetur që e mbrapshta e KEK-ut filloi me një fond prej 5.4 milionësh të dhënë nga AER nëpërmjet UNMIK-ut për punëtorët e KEK-ut, të cilat në fund i përvetësuan, sipas hetuesve të OLAF-it, Joan Pierce e Mott McDonald.

OLAF-i ngriti dyshime edhe për tenderët njëburimor të përfituar nga kompania franceze “Allstom”, kompania gjermane “Siemens”, kompanitë “Swedpower”, “Wattenfall”, “ESBI”, “Llyr Rowlands”, etj.

Për krejt këto, e shumë çështje të tjera të ngritura nga hetuesit e OLAF, ditë më parë ka shkruar ed-

he gazeta italiane “La Repubblica”. Gazeta shkruan se Parlamenti Evropian dyshon për shpërdorime masive të fondeve ndërkombëtare për Korporatën Energjetike të Kosovës dhe Aeroportin e Prishtinës. Fjala është për 11 dosje lidhur me hetimin se ku kanë shkuar 3 miliardë euro financime për rindërtimin e Kosovës. Këto dy subjekte, KEK-u e Aeroporti kanë qenë përfituesit kryesorë të 3 miliardë eurove fonde ndërkombëtare, që u dhanë nga donatorët në arkat e UNMIK ut.

Sipas shkrimit , EULEX po pengon dhënien e një informacioni të plotë, sidomos lidhur me KEK. Një kërkesë për sqarime që i ishte dorëzuar Olli Rehnit, komisionar për Zgjerimin në vitin 2008, nga Parlamenti Evropian, nuk mori nga ky i fundit përgjigje deri në përfundimin e mandatit të tij.

EULEX nuk ka pasur përgjigje as për “Preportr”, kur është pyetur nëse janë nisur hetime për dyshimet për keqpërdorime në KEK.

MASOUD KEKYAN — ZOTI I ENERGJISË

Këshilltarët e huaj në KEK pyeten që nga blerjet e mëdha, tek dokumentet strategjike e deri në largim të punëtorëve nga puna. Nga komunikimet interne shihet se këshilltarët e huaj kontrollojnë prokurimin dhe blerjet që kapin vlera milionëshe, por fuqia vendim-marrëse e tyre shkon deri aty sa edhe i rekomandojnë menaxherëve të distrikteve rajonale që të përjashtojnë punëtorë nga puna. Këta këshilltarë, komunikojnë/ndikojnë edhe deputetët kur duhet votuar ndonjë dokument i rëndësishëm. Në anën tjetër, ata nuk i japin llogari askujt. Po ashtu ata nuk marrin përgjegjësi për dështimet. Janë të padukshëm e të paprekshëm.

BESA KALAJA E BESNIK BOLETINI



Sektori i energjisë në Kosovë është i dominuar nga organizata, konsulentë e kompani ndërkombëtare. Konsulenca të vazhdueshme ndërkombëtare dhe investimet e pafund nuk kanë rritur efikasitetin e këtij sektori. Në KEK nuk është dhënë përgjegjësi asnjëherë për dështimin e dhjetëra milionëve investime, por as për faktin se ky sektor përkundër konsulencave të shumta ndërkombëtare dhe resurseve të pakufishme natyrore, nuk u ngrit në këmbë ndonjëherë.

Kosova jeton mbi rezervat e pesta në botë të linjtit, por vazhdon të ketë reduktime me shumë se çdo vend në rajon. Një pjesë e mirë e investimeve në KEK kanë dështuar, kurse rryma vazhdon e blihet me pesëfishin e çmimit të eksportit të saj nga Kosova.

Potenciali energjetik i Kosovës është enorm dhe dokumente të rëndësishme ndërkombëtare për sektorin e energjisë e shohin Kosovën si një furnizuese të rëndësishme për Ballkanin. Duke analizuar mënyrën e menaxhimit të këtij sektori mund të kapen disa paradokse. Investimet e shumta nën tutorimin e kompanive konsulente ndërkombëtare mund të konsiderohen se kanë dështuar në krijimin e një sektori të qëndrueshëm energjetik.

Të njëjtat kompani e individë

të jashtëm që “këshilluan” Qeverinë e Kosovës vazhdojnë të merren edhe me hulumtimet e analizat që përgatisin këtë sektor për privatizim. Dështimi i këtyre konsulencave nuk është konstatuar asnjëherë nga punëdhënësi i tyre, në këtë rast Qeveria e Kosovës, por e vërteta është që me tërë ekspertizën e tyre KEK-u nuk u bë ndërmarrje rentabile. Kjo para së gjithash për shkak se institucionet e Kosovës pothuajse nuk janë marrë me krijimin e politikave në këtë sektor, por kanë pasur pak rol edhe në nivelin e menaxhimit të ndërmarrjes së vetme të rëndësishme për energji në Kosovë, KEK-ut.

Ajo që karakterizon këtë sektor është mungesa e masave kundër personave e kompanive që dogjën miliona euro investime, edhe pse ndonjëherë këto dështime të investimeve janë dukur sikur të ishin sabotazhë ndaj kësaj kompanie. Madje në disa raste të investimeve të dështuara ka raste kur kompanitë që kanë bërë liferimet e pajisjeve milionëshe kanë vazhduar të shpërblehen me tenderë nga KEK-u edhe pse kësaj korporate i kanë shitur pajisje të prishura dhe e kanë dëmtuar për miliona euro.

Përfaqësuesit e KEK-ut japin përgjigje kontradiktore ose nuk japin fare kur pyeten nëse është ndërmarrë diçka në lidhje me dëmtimin e KEK-ut nga kompanitë e

ndryshme. Me ndikimin e këshilltarëve të huaj dhe lidhjeve të tyre me kompani të huaja, KEK-u bëri shumë blerje me kosto shumë më të shtrenjta përmes tenderëve njëburimor, blerje që shpesh kanë dështuar, ndërsa janë refuzuar ofertat më të lira.

SPASTRIMI I TERRENIT NGA KUNDËRSHTARËT

Këshilltarët e huaj ende e kanë në dorë plotësisht menaxhimin e KEK-ut. Por edhe këta këshilltarë e kanë “bossin” e tyre, e ai është Masoud Keyan, i cili është angazhuar në KEK në fillim të vitit 2007 pothuajse njëkohësisht me ish-drejtoreshën Pranvera Dobruna. Sipas njerëzve që kanë punuar dhe punojnë ende në KEK, Keyan tërë këtë kohë ka qenë njeriu kryesor në këtë korporatë dhe pa “aminin” e tij nuk mund të bëhet asgjë. Masoudi është i kontraktuar përmes USAID-it si përfaqësues i kompanisë “PA Consulting”, por edhe pse kompania këshillëdhënëse ka ndryshuar, Keyan ka ngelur stoik duke u angazhuar edhe me kompaninë pasuese në KEK, “Tetra Tech”. Të gjithë ata që kanë kundërshtuar propozimet e tij janë larguar nga puna dhe janë zëvendësuar nga njerëz të dëgjueshëm që i nënshkruajnë e aprovojnë kërkesat e tij.

“Preportr” ka gjetur një listë

me dhjetëra persona që janë larguar nga puna, brenda pak muajsh, pa u vlerësuar si duhet performanca e tyre. Krejt kjo ka ardhur sipas njerëzve që i njohin rrethanat në KEK dhe që kanë punuar aty, si spastrim i terrenit nga Keyan prej njerëzve që do të mund t’ia “zinin rrugën”.

Të larguar sipas një liste që e ka siguruar “Preportr”, janë: Visar Kelmendi, Fëllanza Hoxha, Fëllanza Pula, Selami Gashi, Lazër Krasniqi, Shemsedin Klaiqi, Farhedin Maqestena, Nazmi Gashi. Kjo listë nuk përfundon me këta emra. Një komunikim i brendshëm tregon për presionin që këshilltarët ndërkombëtar i kanë bërë menaxhmentit për të larguar nga puna të tjerë punëtorë nën arsyetimin e “performancave të dobëta”.

Përfaqësues të sindikatës së Elektrokosovës thonë se veç këtyre menaxherëve, ka edhe shumë të larguar në nivel të distrikteve. Numri i tyre shkon në dhjetëra dhe asnjërit prej tyre nuk i është dhënë ndonjë arsye konkrete për pushim nga puna. Madje sipas drejtuesëve të Sindikatës së Elektrokosovës punëtorët që largohen nga puna në KEK nuk kanë të drejtë ankese. Ata kryesisht janë njerëz me përvojë prej dekadash në punën e tyre, që nuk janë pajtuar me mënyrën e menaxhimit të KEK-ut nën grushtin e Keyan. Dominimi i këshilltarëve të

huaj tashmë është bërë një mënyrë e menaxhimit në KEK, pasi që edhe këshilltarët e tjerë më të “vegjël”, japin urdhra ekzekutive, duke rekomanduar hapjen e konkurseve në mënyrë të vazhdueshme dhe duke përjashtuar punëtorë që kanë punuar që disa vite, gjoja për shkak të performancave jo të mira.

Në një komunikim me shkrim që ka siguruar “Preportr” njëri prej këshilltarëve të huaj, Babukhadia Irakli, ua ka kërkuar menaxherëve të distrikteve rajonale largimin e menjëhershëm nga puna të punëtorëve që kanë punuar në inkasim. Gjuha që përdoret në këtë e-mail është urdhëruese dhe ekzekutive, duke ua kujtuar menaxherëve që nëse nuk implementohen ndryshimet që i janë bërë Rregullores së Distriktit do të ndërmerren masa administrative ndaj tyre. Në këtë letër si arsyetim përdoret “performanca e dobët”, por përfaqësuesit e sindikatës thonë se këto largime bëhen pasi që bëhen lista pritjeje nga njerëz tjerë që kërkojnë të punësohen në KEK dhe prandaj duhet larguar punëtorët aktual për të liru vendin të përzgjedhurve të këshilltarëve ndërkombëtarë. “Preportr”, gjithashtu ka siguruar edhe dokumente të tjera ku shihet pozita dominuese, vendim-marrëse e këshilltarëve të huaj, të cilët në fakt janë shefa si dhe nënshtrimi i vendorëve ndaj tyre.

► VAZHDON NGA FAQJA 5

NA KENI NDIHMU, NA KENI.....

Avni Kurshumliu, i cili në KEK ka punuar për 40 vite, thotë se Masoud Keyan ka fuqi të madhe në KEK pasi e ka përkrahjen edhe nga vetë kryeministri. Për më tepër ai thotë se këshilltari i KEK-ut hyn pa trokitur në zyrën e kryeministrit.

“Mbështetja ka qenë shumë e fuqishme dhe është edhe sot nga USAID-i dhe presioni nga Ambasada Amerikane tek Qeveria e Kosovës për të mos lëshuar pe nga kjo rrugë dhe kjo strategji nuk udhëhiqet vetëm në Bordin ekzekutiv, por edhe në Bordin drejtorëve. Pra problemi më i madh i KEK-ut nuk janë ekzekutivët, por bordi i drejtorëve të cilët vetëm janë marioneta dhe kanë për t'i çuar duart për të miratuar çdo propozim”, ka thënë Kurshumliu.

Mbështetjen e Qeverisë së Kosovës dhe Ambasadës Amerikane që e ka Keyan e pranon edhe ish-ministria e Energjisë dhe Minerave, Justina Shiroka-Pula.

“Ai në fakt e menaxhon KEK-un edhe pse ka ardhur si këshilltar për ta rregulluar situatën në distribucion. Pra ky ka ardhë si ekspert për ta rregulluar situatën në distribucion dhe tash po shihen rezultatet e tij. Është e treta qeveri që Masoudi është pjesë e menaxhimit në mënyrë direkte apo indirekte”, thotë Shiroka-Pula.

Për ta dëshmuar fuqinë e tij në KEK, ish-ministria Shiroka-Pula, tregon se kur e ka marrë timonin për të udhëhequr me ministrinë, ka gjetur shumë dokumente ku ai ose bashkëpunëtori i tij kanë qenë pjesë e pranimi të punëtorëve në KEK, pjesë e tenderëve dhe proceseve të ndryshme.

“Ndërsa më vonë nuk kam gjetur dokumente ku ai ka qenë pjesë, por të gjithë në KEK dhe ne e dimë që ai e menaxhon KEK-un për shkak se ka përkrahjen nga institucioni i cili e ka angazhuar. Çdo ndryshim pozitiv që ka pak, apo negativ është nën direktivat e tij”, thotë ajo.

Për të gjitha këto çështje, Preporti ka tentuar që të bisedojë edhe me drejtorin gjeneral të KEK-ut Arben Gjukaj, sikur edhe me vetë Masoud Keyan, por kjo nuk na është mundur. Për intervistimin e Gjukajt, Zyra për informim e KEK-ut ka kërkuar të bëhet kërkesë. Edhe pse kjo kërkesë është bërë me datën 25 qershor, nuk na është mundur takimi.

Ndikimin e madh të Keyan në KEK e tregon ish-drejtori financiar i kësaj korporate, Visar Kelmendi. Ai thotë se Keyan ka ardhur me strategji për ndërrimin e drejtorëve.

“Ka qenë strategji e Masoud Keyan krijimi i një ekipi të dyfishtë të drejtorëve për çdo divizion dhe brenda gjashtë muajve fillojnë me ndërrimin e drejtorëve në të cilët ja-

në investuar miliona euro për profesionalizimin e tyre dhe “emërohen disa ‘sabi’, të pashkolluar që të vetmin argument e kanë që dinë të thonë “Yes”.

Sipas tij, çdo plan pastaj është bërë nga të huajt dhe shihej shkrimi që ishte një përkthim me direktiva nga anglisht në shqip, “e që në fakt në shqip as nuk mund të kuptohej mirë, por nënshkrimet ishin të Pranverës, Remzi Shahinit e deri të Arben Gjukaj”.

“Ato dokumente shiheshin që ishin të përpiluara prej “PA Consulting” dhe vetëm i dorëzoheshin drejtorëve shqiptarë për t'i nënshkruar dhe për t'i zbatuar. Çdo propozim i tij, vjen i nënshkruar nga drejtorët e KEK-ut dhe del si propozim i KEK-ut dhe Bordin gjithmonë vetëm jep miratim”, u shpreh Kelmendi.

Ndryshimet kadrovike në KEK i sheh me pesimizëm edhe Naim Hoxha nga Instituti Riinvest. Ai konsideron se është i paarsyeshëm largimi i menjëhershëm i disa menaxherëve nga pozitat e tyre. “Në KEK është bërë një ndërrim i madh i drejtorëve, po jo vetëm i drejtorëve në nivelin gjeneral, por edhe në nivelin e njësive. Pra ka pasur një ndërrim enorm të cilin edhe shtetet më të pasura më kuadro nuk do të kishin mundur ta përballojnë sepse në secilin njësi ka pasur 6 a 7 drejtorë të cilët janë ndërruar”, thotë Hoxha.

Ai thotë se nga KEK-u janë larguar një seri e inxhinierëve të dëshmuar si të suksesshëm dhe në këtë kontekst e përmend Ali Hamitin. “Është e panatyrshme.... nuk po them që është e pamundur, as nuk po them që këta djemtë që janë tani në qeverisje nuk vlejnë, por është e panatyrshme që kuadrot më të mira që i ka pasur Kosova në këtë lëmi dalin të pasuksesshëm dhe përnjëherë dalin të suksesshëm këta që kanë qenë në periferi”, thotë ai.

Të njëjtën gjë e pohon edhe kryetari i Sindikatës së Elektrokosovës Fehmi Pajaziti, i cili thotë se “me direktiva të ndërkombëtarëve në KEK, janë larguar dhe po largohen shumë punëtorë dhe po zëvendësohen me të tjerë që janë më pak të zotë në punën e tyre”.

KËSHILLTARI ANTI-FEMINIST

Fëllanza Pula është emëruar në postin e drejtores së furnizimit me datë 03.04.2007, me vendim të drejtoreshës Pranvera Dobruna, ndërsa me 30.05.2007 është larguar nga ky post pa iu dhënë asnjë arsye. Ajo thotë se arsyeja e largimit ka qenë “mosdëgjueshmëria” e saj për të nënshkruar dokumente të propozuara nga Keyan. Ndërsa “fërkimi” më i madh i saj me Keyan ka qenë kur ky i fundit i ka thënë që ta nënshkruajë një dokument

në të cilin thuhej se nuk mund të bashkëpunonte me drejtoreshën rrjetit, që në atë kohë ishte Fllanza Hoxha dhe përmes këtij nënshkrimi të largohej Hoxha nga pozita e drejtores, pasi që nuk i pëlqente këshilltarit Keyan.

Ajo thotë se vendimi për largim nga puna nuk ka përmbajtur asnjë arsye dhe për këtë ajo ka kërkuar sqarime nga Bordin i Drejtorëve të KEK-ut. Gjithashtu thotë se është ankuar edhe në Inspektoratin e Punës, por nuk është bërë asgjë.

Pas këtij largimi nga puna, Fllanza Pula ka paditur KEK-un dhe e ka fituar rastin dhe gjykata e ka urdhëruar KEK-un për ta kthyer në punë, por ajo nuk është kthyer në postin që e ka pasur. Asaj i është ofruar një post tjetër i cili “nuk ka ekzistuar kurrë”. Dhe me datë 22.08.2007 u.d i drejtorit Remzi Shahini ia shkëput marrëdhënien e punës me KEK-un me arsyetimin se kjo pozitë nuk ekziston dhe nuk është e nevojshme.

Largimin e Fëllanza Pulës e kanë kundërshtuar edhe menaxherët e të gjitha njësive të divizioneve të furnizimit, të cilët kanë kërkuar nga Bordin i Drejtorëve të KEK-ut dhe nga institucionet relevante që të shqyrtohet vendimi në fjalë, pasi që “drejtoresha Pula ka pasur përformancë të mirë gjatë punës së saj”.

“Propozimet kanë qenë të shumta, që nga kërkesat e thjeshta e deri tek kërkesat që unë të nënshkruaj që nuk kuptohem apo kemi mosmarrëveshje me drejtoreshën e rrjetit. Por në fakt, unë me drejtoreshën e rrjetit kam pasur bashkëpunim shumë të mirë, pasi që bashkë me të e kemi përgatitur para kohe planin e biznesit dhe planin aksional të rrjetit dhe furnizimit. Pra një prej arsyeve që më ka larguar nga puna Masoud Keyan ka qenë mosdëgjueshmëria”. Sipas saj Keyan nuk bën asgjë direkt, por e shfrytëzon ndikimin vet për t'i realizuar planet. “Jo zyrtarisht ka thënë se drejtori duhet me qenë i dëgjueshëm ndaj shefit, e në atë kohë shefe ka qenë Pranvera Dobruna”, thotë Pula.

Ajo thotë se Masoudi ka qenë hapur kundër femrave që janë në pozita ekzekutive, ndërsa i ka larguar ato që nuk ia kanë përfillur propozimet. “Masoud mendon se nuk duhet me pas femra në pozitë, pra është komplet shovinist”.

“Mua ma ka thënë që femrat dinë vetëm të flasin për flokë, për shminka, për gardërobë” thotë Pula. Ajo thotë se për këto fyerje i ka shkruar punëdhënësit të Keyan, por nuk ka marr asnjë përgjigje.

Pas vendimit për largim, Fëllanza Pula thotë se i është ofruar një deklaratë për ta nënshkruar. Në këtë deklaratë thuhet se ajo nuk do të ngre padi kundër KEK-ut, apo ndon-

Të larguar nga puna pas ardhjes në

KEK të Masoud Keyan janë:

Visar Kelmendi,
Fëllanza Hoxha,
Fëllanza Pula,
Selami Gashi,
Lazër Krasniqi,
Shemsedin Klaiqi,
Farhedin Maqestena,
Nazmi Gashi.

Kjo listë nuk përfundon me këta

emra. Një komunikim i brendshëm

tregon për presionin që këshilltarët

ndërkombëtar i kanë bërë

menaxhmentit për të larguar nga

puna të tjerë punëtorë nën arsyetimin

e “performancave të dobëta”.

jë zyrtari të kësaj korporate dhe do të pranojë 11 mijë e 400 euro ne emër të shkëputjes së kontratës. Ajo thotë se i është thënë se ky dokument nuk duhet që të dalë jashtë KEK-ut.

Nga ardhja e Keyan në KEK janë larguar menaxherë me përvojë disa dekadësh. Një nga ta ishte edhe Fëllanza Hoxha, e cila ka punuar si menaxhere dhe drejtor në Distribucion për 28 vjet. Burime nga brenda thonë se Hoxha është larguar pas disa mospajtimeve të saja me këshilltarin Keyan. Që Masoudi kishte ardhur me tendencën e pastrimit të terrenit nga “njerëzit e padëgjueshëm”, ndaj tij e thonë edhe Visar Kelmendi ish-drejtor financiar dhe Skënder Krasniqi, ish-kryetar i bordit të drejtorëve në KEK.

Të dy thonë të mos kenë qenë në të njëjtin mendim me Keyan. Skënder Krasniqi thotë se me të takuar atë (në një mbledhje të Bordit), kur ai ka folur nga mbrapa, ky i ka sugjeruar të heshte pasi nuk kishte dijeni se kush ishte dhe çfarë përfaqësonte. Largimi i tij thotë të mos ketë ardhur nga ky fërkim, por që ai vetë nuk kishte konkurruar për pozitën e kryetarit të Bordit të Drejtorëve ku ka qenë ushtrues detyre për 6 muaj.

Ndërsa Visar Kelmendi thotë se ndikimi i Masoudit në Pranvera Dobrunë bëhet shumë i madh. Sipas tij, në takimin e parë të Bordit, Dobruna thotë se prej sot jam drejtoreshë dhe fjalën po ia jep zotit Masoud Keyan, ndërsa ky i thotë veç dy fjalë: ‘krejt çka keni bërë me ESBI-n nuk vlen dhe ky Bord nuk ka për të ekzistuar më’.

“...pa e kryer fjalën unë i kërkoja shpjegim se me çfarë kompetencash po flet para Bordit, kurse ai reagoi shumë fort dhe mbledhja u mbyll atë ditë”, thotë Kelmendi. Pas një jave Pranvera e mbyll divizionin e Kelmendit dhe e lë atë pa vend pune.

SHKON BREGU TE MASOUD-I

Shkon mali te Muhamedi, apo Muhamedi te Mali? Është kjo një metaforë me të cilën mund të kuptohet rëndësia e Masoud Keyan në KEK. Në fillim të vitit 2007, Keyan ka ardhur si këshilltar i kontraktuar nga USAID me kompaninë “PA Consulting”. Kështu, në maj 2010, “PA Consulting” ka qenë poashtu kompania që është angazhuar për të bërë vlerësimin e termocentralit Kosova B. Më vonë kur Keyan kalon me kompaninë tjetër konsulente që angazhohet për këshilldhënie në KEK, sipas “Kosovo Energy Sector Strategy Briefer” “Tetra Tech” bën edhe një vlerësim të fizibilitetit të termocentralit Kosova B. Sipas ekspertëve, në këtë termocentral, hulumtimi i fundit ka treguar se ky termocentral është riparuar deri në masën sa që mund t'i jetë ripërtërirë jetëgjatësia për disa dekada

Këto studime nuk i janë dhënë Qeverisë së Kosovës. Përfaqësues të

Masoudi e bëri terrenin për privatizimin e distribucionit

ESBI sipas Kelmendit kishte bërë ndarjen e distribucionit në dy pjesë: në pjesën e furnizimit dhe pjesën e distribucionit e cila e ka rrjetën dhe i mirëmban trafot e rrjetave, shtyllave, etj. “Tri vite kemi punuar për krijimin e mekanizmave ndarës. Qëllimi ka qenë që të plotësohen direktivat për liberalizim të tregut në kuptimin që furnizimin kemi mundur ta shesim, por mos të shitet aseti, të ruhet rrjeta, e cili është parakusht esencial për zhvillim nesër”, thotë ai. Sipas Kelmendit edhe strategjia e krijuar prej Qeverisë 2005-2015, bazën e ka pasur në privatizimin e furnizimit.

“Kjo ndërron menjëherë dhe askush nuk po reagon. Nuk reagon askush sepse Masoudi e përgatiti dhe nuk iu la zgjidhje tjetër. Këtu ideja është i një privatizimi tragjik. Ideatori i gjithë kësaj është Masoud Keyan”, theksoi Kelmendi.

Privatizimi i distribucionit në mënyrën qysh po bëhet sipas njohësve të energjisë është i padobishëm dhe këtu mund të ketë ndikim edhe Keyan.

“Edhe në strategji kemi pasur shumë dilema dhe probleme sa i përket distribucionit për shkak se ne jemi nënshkrues të traktatit për komunitetin e energjisë dhe sipas traktatit dhe direktivave të BE-së, distribucionit duhet të ndahet nga shërbimet e furnizimit, mirëpo me presione të ndryshme dhe me qasjen që Keyan e ka, është sjellë kjo situatë”, thotë ish-ministrja e Energjisë dhe Minierave, Justina Shiroka-Pula.

Të njëjtën gjë e mendon edhe Fehmi Pajaziti, kryetar i sindikatës së Elektrokosovës. Ai thotë se privatizimi është shumë i papërshtatshëm dhe këtë privatizim në këtë mënyrë

qysh po ndodh, “mund ta kenë shtyrë vetëm këshilltarët e jashtëm”.

Visar Kelmendi thotë se privatizimi nuk nënkupton edhe heqjen e barrës që ka qeveria sa i përket furnizimit me energji elektrike.

“Me këtë koncept që po e thonë qeveritë se nuk kemi çfarë të bëjmë dhe po ia shesim me çmim të lirë dikujt (distribucionin), në fund strategjikisht askush nuk e merr përgjegjësinë për furnizim, prapë qeveria duhet me e zgjidh problemin e furnizimit, inkasimin, vjedhjes së energjisë, problemin e investimeve në distributim. Pra edhe nëse krejt e falë, nuk i hiqet përgjegjësia qeverisë”, mendon Kelmendi.

Me këtë privatizim të distribucionit Shiroka-Pula, thotë se qeveria nuk po bën asgjë tjetër vetëm se po e bën një transformim nga një monopol shtetëror në atë privat.

“Efekti ekonomik do të jetë shumë i dëmshëm për konsumatorin dhe zhvillimin ekonomik të vendit, sepse zvogëlimi i të gjitha humbjeve do të bëhet me ngritjen e çmimit të energjisë elektrike, ndërsa mos pagesa faturave do të mbetet problem i qeverisë”.

Edhe ish-ministrja Pula mendon se e udhës ka qenë të privatizohet vetëm furnizimi po jo edhe rrjeti. Prandaj, sipas saj, gabim strategjik do të ishte privatizimi i rrjetit të energjisë i cili do të bëhet monopol i një kompanie private dhe kjo kompani private do të diktojë çmimin e transitit të energjisë do të kufizojë zhvillimin e rrjetit në përgjithësi si dhe kërkesat e reja për zhvillimin e pjesëve të caktuara të vendit. “... duhet të shihet kontrata po unë parashikimet i kam të zymta, sepse tash do të vijë deri te shtrenjtimi i rrymës dhe furnizimi nuk do të jetë më i mirë”, thotë Naim Hoxha nga Riinvest.

Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, në kuadër të së cilës është sektori i energjisë, kanë thënë se kompania që ka bërë vlerësimin e Kosovës B thjesht “ka ndarë të gjeturat kryesore” të këtij vlerësimi, por nuk i ka dhënë qasje qeverisë në këtë dokument. Këto dokumente si do që të jetë kanë një rëndësi të veçantë në ndërtimin e strategjisë për sektorin e energjisë. Deputetë të Kuvendit të Kosovës thonë se presionet më të mëdha për ta apr-

ovuar dokumentin strategjik për sektorin e energjisë në Kuvend i kanë bërë pikërisht këshilltarët ndërkombëtarë. Në disa prononcime për media edhe vetë ish-ministrja Pula-Shiroka ka folur për një “presion enorm” të këshilltarëve ndërkombëtarë në Parlament për kalimin e Strategjisë për Energjinë.

Fakti që Qeveria e Kosovës pranon se nuk ka në posedim vlerësime të tilla siç janë ato të fizibilitetit për termocentralin

Kosova B, tregon se sa i përjashtuar është ekzekutivi nga këshilltarët ndërkombëtarë në sektorin e energjisë. Kryeministri i Kosovës nuk e ka asnjë këshilltar për energjinë, por ata që kanë frekuentuar takimet për këtë sektor thonë se ai thjesht i ka lënë këtë sektor zotit Keyan. Pothuaj se të gjithë ekspertët vendor që merren me energji kanë kundërshtuar në vazhdimësi zgjidhjet strategjike për energjinë.



Favorizimi i Serbisë

Vetë Masoud Keyan nuk ka pranuar të flasë për “Preportr” duke thënë se ai thjesht është këshilltar dhe nuk ka pse të flasë. Sido që të jetë një deklaram i vetëm i tij për tërë këtë kohë është dhënë për portalin JNK, në të cilin ai në mënyrë indirekte pranon rolin ekzekutiv të tij.

“Është e vërtetë se çmimet e energjisë që importohet në Kosovë ofrohen - në pjesën më të madhe - janë mbi çmimin e tregut (madje edhe gjykuar nga standardet rajonale)”, ka thënë Keyan. “Kjo kryesisht vjen si pasojë e rolit pengues të Serbisë e cila deformon çmimin. KEK’u po shikon të ngrehë këtë temë me Sekretariatit e Komunitetit të Energjetikës në Vjenë - pasi veprimet e Serbisë mund të jenë duke thyer rregullat e BE’së për energji”, i ka thënë JNK-së, Masoud Keyan.

Edhe pse KEK në vazhdimësi premton se do të ndërmarrë masa për dëmet që l shkaktohen KEK-ut si pasojë e investimeve të dështuara dhe blerjes së energjisë shumëfish mbi çmimin e tregut, deri më sot nuk ka ndonjë veprim të tillë.

Keyan ka dhënë për JNK një tabelë që, sipas tij, tregon përmirësimin e performansave të KEK-ut. Përmirësimin e performansave, Keyan e sheh në ngritjen e faturimit dhe të inkasimit. Mirëpo, kjo ngritje shpjegohet thjesht duke pasur parasysh se që prej kur Keyan ka ardhur në KEK importimi i energjisë është shumëfishuar. Kështu, nga 16,7 milionë euro në vitin 2005, importi ka kërcyer për gati trefish, përkatësisht në mbi 45 milionë euro. Pra, këtu nuk bëhet fjalë për përmirësim të performansave të KEK-ut, por për shtimin e shpenzimeve të Buxhetit të Kosovës për të blerë më shumë rrymë. E rrymë më shumë është blerë kryesisht me një çmim shumëfish më të lartë sesa ai i tregut, që sipas Keyan ka ardhur si pasojë e obstrukcioneve nga Serbia. Pra, këtu thjesht kemi një kontradiktë në argumentimin e Keyan duke qenë se obstrukcioni nga Serbia nuk e ka bërë KEK-un në epokën e Keyan të reduktojë importin nga ky shtet, por përkundrazi, ta shumëfishojë atë.

Kosova nuk ka vetëm një linjë të inter-koneksionit ndërkombëtar me Serbinë. Ajo ka një të tillë me Malin e Zi dhe një tjetër me Maqedoninë, ndërkohë që një e tillë me Shqipërinë, e cila për shkak të mundësisë së komplementimit të resurseve shihet me shumë rëndësi, po shtyhet tash e sa vite. Zyrtari i KOSST, i cili është i vetmi nga drejtorët e hershëm që ka mbijetuar epokën e Keyan, Fadil Ismaili, nuk ka dhënë informacion mbi atë se sa rrymë blihet nëpërmjet linjës së interkoneksionit me Serbinë se sa me linjat tjera. Në asnjë raport të KOST nuk jepet kjo e dhënë, dhe përgjigjen në këtë pyetje nuk e ka dhënë asnjë zyrtar. Sido që të jetë, nëse Kosova ka vazhduar për shumë vite të blejë rrymën me një çmim tre herë nga çmimi i tregut, dhe nëse qëndron konstatimi i Keyan dhënë JNK-së se ky çmim paguhet për shkak të obstrukcioneve të Serbisë, atëherë mund të konstatohet që KOSST ka bërë terminimin e energjisë kryesisht nëpërmjet linjës së interkoneksionit me Serbinë.

Pra, çmimet e importit kanë pasur pak a shumë të njëjtën shkallë për vite me radhë, duke lënë të kuptohet se Serbia ka qenë kryesisht rruga apo furnizuesi që KEK-u dhe KOSST kanë shfrytëzuar. Në pyetjet dërguar KOSST-it, nuk fshihet e dhëna se sa rrymë është transportuar me linjat tjera, por thjesht thuhet se linja me Malin e Zi shkon në riparim pothuajse çdo vit.

Sipas një raportimi të gazetës “Express” në vitin 2008 kompania serbe, Rudnap, blinte energjinë elektrike me 42,11 euro nga Kosova dhe shiste me 119- 132 euro për megavat. CEZ-i paguan 41,14 euro, ndërsa “Reatia Energjia” nga 46 -48,2 euro. Kompania çeke, EFT, në bazë të një kontrate KEK-u ti shet energjinë elektrike me 42,67 dhe 43, 10 euro për megavat, përderisa po nga e njëjta kompani, një megavat e blen 123-128 euro. “Espada” po ashtu çeke ka blerë nga KEK-u energji me nga 41 euro dhe shet me 129.5 euro për megavat. Zvicëria EGL, në kontratat e fundit për eksport dhe import ka çmimin më të lirë. Blen me 40,75 euro për megavat dhe e shet 119.7.

KEK-U, VENDI KU RRASËN TË GJITHË

AVNI ZOGIANI

Në asnjë vend nuk bashkohen krimi i bizneseve, politikanëve, e individëve vendor e ndërkombëtar si në Korporaten Energjetike e Kosovës – KEK. Aty ndodhë gjithçka. Likuidohen struktura të tëra ekspertësh nga pozitat që mbajnë për dekada me radhë nëse nuk dëgjojnë këshilltarët dekadentë ndërkombëtarë. Aty shihet qartë fotografia e klientelizmit të politikës me tenderët dhjetra milionësh.

KEK-u është kompania në të cilën për dymbëdhjetë vjet me radhë fjalën e fundit nuk e kanë pasur ata që formalisht kanë udhëhequr me të, por vendimet i kanë marrë njerëzit që janë ulur në radhën e dytë të karrigeve, këshilltarët ndërkombëtarë. Ata kanë pasur kompetencat, por jo edhe përgjegjësinë. Ata janë kujdesur që në sektorin e energjisë në Kosovë të ndodhë gjithçka përveçse të gjinden zgjidhjet.

Prokurimet e KEK-ut janë dominuar nga politika edhe vendore edhe ndërkombëtare dhe kjo shihet në faktin se dhjetra- miliona euro janë djegur në mënyrën më bizare të mundshme. Kompanitë vendore e ndërkombëtare e kanë furnizuar KEK-un me paisje të vjetra, të lyera me bojë të re, të cilat kanë dështuar sapo janë vënë në punë. Këto kompani nuk kanë pësuar asnjë pasojë, asnjë masë nuk është ndërmarrë kundër tyre. Këto kompani kanë vazhduar të marrin tenderë dhjetra milionësh pa iu prishur ty mi i duhanit.

Një kompani ndërkombëtare ka akzuar direkt një të afërm të kryeministrit se ka ndalur termocentralet nga prodhimi për të blerë rrymë nga grupi që është identifikuar si “mafia energjetike e Ballkanit”. Ky kushëriri i kryeministrit që ka udhëhequr prokurime që i kanë djegur KEK-ut dhjetra- miliona euro është promovuar në drejtor të gjenerimit, përkatësisht në zëvendësdrejtor të KEK-ut. Është ky Njazi Thaçi që për vite me radhë udhëhoqi Zyrën e Prokurimit të KEK-ut. Këtë zyrë që bleu transformatorin e vjetër për tri herë më shtrenjtë sesa një i ri, për t’u djegur për disa orë. Ky është njeriu që nënshkroi afro 50 milionë euro kontratë me kompaninë shtetërore serbe “14. Octobar”, ndërkohë që Serbia me obstrukcionet e sa-

ja ka ngritë çmimin e importit të energjisë Kosovës për tre deri në pesëfish nga çmimi i tregut.

Një tjetër njeriu në KEK nuk ia di kush fytyrën. Masoud Keyan, i angazhuar nga USAID që nga viti 2007, sipas menaxherëve të KEK-ut ka qenë zoti i vërtetë i energjisë në Kosovë. Nga intervistat me ish-zyrtarë të KEK-ut, Keyan na del një lloj Njazi Thaçi lokal, sado që ndonjëherë në rivalitet me këtë të fundit, jo për arsye parimore, sa për të kontrolluar më shumë. Njeriu që për tërë këto vite ishte ministri i vërtetë i energjisë, sipas njerëzve të angazhuar në këtë sektor, i ka përcjellur me nga një shqelm të gjithë ata që kanë kërkuar të debatohen “këshillat” e tij. Nga ardhja e Keyan në KEK fondet për import të energjisë janë shumëfishuar, por ai prapë insiston se performancat e KEK-ut janë ngritur.

Për tërë këto vite, ata që kanë dëmtuar më së shumti sektorin e energjisë në Kosovë kanë qenë pikërisht ata që kanë marrë ose ndikuar direkt vendim-marrjen në këtë sektor. Ndryshe nuk shpjegohet fakti se përkundër përparësive të jashtëzakonshme për zhvillim të këtij sektori, KEK-u akoma ka mbetur me të njëjtat probleme me të cilat doli menjëherë pas lufte.

Ashtu sikur Keyan, edhe drejtori i KOSST, Fadil Ismaili, kanë denoncuar deklarativisht obstrukcionet e Serbisë në importin e energjisë, por edhe përkundër premtimeve nuk kanë ndërmarrë asnjë gjë për ta ndryshuar këtë. Kosova ka tri rrugë për importin e energjisë. Njëra e lidhë atë me Maqedoninë, njëra me Malin e Zi dhe tjetra me Serbinë. Kosova nuk ka interkoneksion vetëm me Shqipërinë. Deri në vitin 2007 në raportet e KOSST, janë dhënë detaje se prej cilës rrugë është importuar energjia. Prej ardhjes së Masoud Keyan, kjo e dhënë nuk jepet në këto raporte, por këtë të dhënë nuk e jep as KOSST përkundër insistimeve tona të vazhdueshme. Në rast se bëhet një interpretim logjik i fenomenit që e fsheh KEK-u për publikun, fakti që ne gjithmonë kemi paguar energji me çmim shumëfish më të lartë sesa ai i tregut, i bie që shumica e importit është bërë nëpërmjet Serbisë. Në anën tjetër, kompani serbe, ose të kompani të huaja të lid-

hura me Serbinë, i kanë shitur më së shumti energji Kosovës.

Të gjithë këta faktorë tregojnë se KEK-u është sabotuar qëllimisht dhe sistematikisht. Sabotimi i parë dhe më i madh ka ardhur nga vetë Serbia. Duke e ditur varshmërinë që Kosova ka nga importi për shkak se strukturat udhëheqëse të sektorit të energjisë kanë nënshkruar kontrata kush-tëzuese që kanë obliguar Kosovën për të importuar, edhe nëse për import nuk ka nevojë, kompanitë serbe, siç është për shembull “14. Octobar”, i kanë dhënë KEK-ut paisje të papërdorshme nëpërmjet zyrës së prokurimit të prirë nga kushëriri i kryeministrit. Pra, motivi i Serbisë për ta sabotuar KEK-un është i qartë. Përveç politik, ky motiv ka qenë vazhdimi i varësisë prej importit.

Motivi i ndërkombëtarëve për sabotimin e KEK-ut në anën tjetër ka pasur dy anë të medaljes. Një KEK jofunksional, do të siguron-te kontrata milionëshe për “konsulencë” për PA Consulting dhe për Tetra Tech, të dyja të përfaqësuara për vite me radhë nga i njëjti njeri, Masoud Keyan. Ndërkombëtarët kanë pasur edhe motiv ideologjik për ta mbajtur KEK-un jofunksional. Ai qëndron në logjikën korporatiste të zbatuar në Kosovë nga të huajt që konsiston në logjikën që çka është në pronësi publike është e dëmshme, e papërspektivë. Sado që ky qëndrim ka një kontradiktë të thellë brenda, sepse KEK-u për tërë këto vite ka pasur si menaxherë kompani private të huaja dhe asnjëherë nuk është menaxhuar si pronë publike.

Motivi i politikës kosovare për ta mbajtur KEK-un jofunksional, përveçse ka pasur si bazë marrëdhënien klienteliste të saj me kompani që kanë marrë dhjetra- miliona nga KEK-u, ka qenë i nxitur edhe nga ndërkombëtarët. Ata thjesht i janë bindur qëndrimit se Kosova nuk mund të menaxhojë vetë me sektorin e energjisë. Energjia e Kosovës potencialisht është tepër e rëndësishme për Ballkan për të qëndruar në duar të shtetit të Kosovës. Kështu, KEK-u, është trajtuar nga të gjithë si një fëmijë pa prind, i cili duhet t’iu shërbejë të gjithëve deri në vetëmohim. Përrallë nga ato më depresivet të vëllezërve Grim është KEK-u.